

Koordinatori: Anesti Kapurani
Adrese email: nestikapurani@yahoo.it
Tel: +355695305539
Orari i punës:
E hënë – E enjte 08:00 – 16:30
E premte 08:00 – 14:00
Adresa: Lagjja: "Brigada 17 Sulmuese", Rr. "Qemal Stafa", Elbasan.

Në mbështetje të ligjit nr.114/2016 “Për të drejtën e informimit” Kërkesa për informim bëhet **me shkrim (sipas formatit bashkëlidhur)** ose në linkun <http://prefektielbasan.gov.al/167-2/>, dhe dërgohet në institucionin tonë pranë zyrës së protokollit dorazi ose me postë, në adresën **Lagjja: "Brigada 17 Sulmuese", Rr. "Qemal Stafa", Elbasan**, në adresën zyrtare të email: prefekti.elbasan@mb.gov.al, ose në adresën email të Koordinatorit nestikapurani@yahoo.it, institucioni do të kthejë përgjigje sipas format në lidhjen nr.2 ose në linkun <http://prefektielbasan.gov.al/167-2/>.

Në mbështetje të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” në rast se nuk merrni përgjigje brenda afatit të parashikuar në ligj ose mendoni se përgjigja nuk është e plotë ju mund të ankoheni brenda 30 ditëve pune nga dita kur:

- a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit;
- b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit, pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ia kalon atë strukturës që merret me të drejtën e informimit, e cila verifikon faktet dhe bazën ligjore të ankesës. Për këtë qëllim, ai mund t’u kërkojë ankuesit dhe autoritetit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim, si dhe të informohet nga çdo person dhe burim tjetër. Kur e sheh të nevojshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale merr vendim për ankesën brenda 15 ditëve pune nga dita kur është dorëzuar ankimi.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vendos:

- a) mospranimin e ankesës kur:
 - i) ka kaluar afati i parashikuar në pikën 2 të këtij neni;
 - ii) ankimi nuk paraqitet në formë shkresore;
 - iii) nuk tregohet emri dhe adresa e ankuesit;
- b) pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit publik për të dhënë informacionin e kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme;
- c) rrëzimin e ankesës, pjesërisht ose tërësisht;
- ç) afatin, brenda të cilit autoriteti publik duhet të zbatojë urdhrin.

Ankesa duhet të plotësohet sipas formatit bashkëlidhur, formularin e plotësuar, mund ta dërgoni pranë Zyrës së Komisionerit në adresën e-mail info@idp.al, dorazi ose nëpërmjet postës në adresën: Rr. Abdi Toptani, Tiranë.

Vendimi i Komisionerit ose nëse ai nuk shprehet brenda afatit të parashikuar në ligj mund të ankimohet pranë Gjykatës Administrative kompetente.